

VENDIM
Nr. 1059, datë 23.12.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT E EFIÇENCËS SË DROSELAVE PËR NDRIÇIM FLUORESHENT”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e efiçencës së droselave për ndriçim fluoreshent”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Rregullore e Komisionit nr.245/2009, 18 mars 2009, mbi zbatimin e direktivës 2005/32/EC në lidhje me kërkesat e efiçencës së droselave për ndriçim fluoreshent, që shfuqizon direktivën 2000/55/EC; nr.celex 31992L0042; Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.76, datë 24.3.2009.